



OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 12

27 janar 2024

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	12 pikë	10 pikë	8 pikë
-Pikët e fituara					

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Vendimi i parë kryesor i Leninit ishte t'i jepte fund pjesëmarrjes së Rusisë në Luftën I Botërore. Marrëveshja e Brest-Litovskit nënshkruar në mars 1918 nënkuptonte që tërheqja nga konflikti i kushtoi vendit territorin që përfshinte $\frac{1}{4}$ e industrisë së tij dhe $\frac{9}{10}$ e minierave të qymyrgurit. Një nga arsyet për këtë veprim ishte lufta civile që kishte shpërthyer sapo bolshevikët kishin marrë pushtetin. Kështu bolshevikët u përballën me kundërshtime nga të gjitha anët. Pavarësisht faktit se menshevikët ishin shumë më shumë në numër, "të kuqtë" ia dolën të fitonin konfliktin. Kjo për shkak jo vetëm të fuqisë së tyre, por edhe si rezultat i dështimit të kundërshtarëve të tyre të mbiquajtur "të bardhët".

a) Analizoni pse dështuan "të bardhët" edhe pse ishin të shumtë në numër.

5 pikë

Kundërshtarët e qeverisë bolshevike (të bardhët) ishin të përçarë. Ata ishin një përzierje mes forcave që mbështesnin Carin dhe kërkoni rikthimin e Romanovëve në pushtet, grupet liberale që kërkonin reforma demokratike, komandantë ushtarakë së bashku me aleatët që dëshironin të qëndronin në Luftën I Botërore. Me kaq grupime të përfshira, asnjë person nuk mund të merrte drejtimin e tyre. Pa një drejtim të unifikuar, menshevikët ishin shumë të dobët. Të bardhët dështuan të siguronin mbështetjen e popullit rus. Lenini u kishte premtuar tokë fshatarëve, ndërsa menshevikët kërkonin rikthimin e Rusisë në kohën e Carit. Kjo do të thoshte se fshatarët kishin frikë nga rikthimi në rendin e vjetër ku ata ishin të shtypur. Edhe propaganda bolshevike e përforconte këtë frikë. Lenini e dinte se lufta duhej të fitohej me çdo kusht. Ai kishte urdhëruar që furnizimet ushqimore të shkonin fillimisht te ushtarët dhe ç'të mbetej t'u shpërndahej atyre që jetonin në qytet. Kjo ishte një nga arsyet që shumë burra rendnin të bashkoheshin me ushtrinë e kuqe, qoftë edhe për t'u ushqyer. Në kushtet e luftës, Lenini ndërmori reformën e njohur si "Komunizmi i Luftës".

b) Lenini e dinte se Lufta duhej të fitohej me çdo kusht. Ai kishte urdhëruar që furnizimet ushqimore të shkonin fillimisht te ushtarët dhe ç'të mbetej t'u shpërndahej atyre që jetonin në qytet. Kjo ishte një nga arsyet që shumë burra rendnin të bashkoheshin me Ushtrinë e Kuqe, qoftë edhe për t'u ushqyer. Në kushtet e luftës, Lenini ndërmori reformën e njohur si "Komunizmi i Luftës".

Analizoni përmbajtjen e kësaj reforme.

5 pikë

Kjo reformë u iniciua për të plotësuar nevojat ekonomike të luftës. U shoqërua me metoda strikte të kontrollit përmes nacionalizimit të industrisë, që nënkuptonte drejtimin e fabrikave nga qeveria duke zbatuar një disiplinë të rreptë. Punëtorët grevistë do të eliminoreshin dhe do të vendosej racionimi i ushqimeve dhe mallrave të konsumit. Gjithashtu shteti sekuestrohte të gjithë grurin dhe produktet e tjera bujqësore. U hoq nga qarkullimin paraja si mjet shkëmbimi të mallrave dhe shërbimeve. Politika funksionoi pasi kishte si qëllim të ndihmonte në fitimin e Luftës. Megjithatë ajo shkaktoi shumë vështirësi për rusët e thjeshtë. Fshatarët refuzuan të bashkëpunojnë me qeverinë, pasi ajo ua konfiskoi tepricën e ushqimit, gjë që solli edhe lënien djerrë të një pjese të madhe të tokës bujqësore duke qenë se fshatari nuk kishte interes të prodhonte më shumë se nevojat e tij. Punëtorët filluan të largohen nga qyteti e të rikthehen në fshat, ku mundësia për të siguruar ushqim ishte më e madhe. Prodhimi industrial ra në 20% më pak se në 1913. Konfiskimi me forcë i grurit i kombinuar me efektin e 7 viteve luftë dhe të një thatësire të madhe, çuan në një krizë urie si rezultat i të cilit, vdiqën 8 milion njerëz.

2. Në vitin 1921 marinarët e bazës detare të Kostandit u rebeluan. Të zemëruar nga mungesa e demokracisë dhe politika e Komunizmit të Luftës, revolta e tyre zgjati rreth tri javë dhe vetëm përfshirja e Ushtrisë së Kuqe e shtypi atë. Kjo protestë i tregoi Leninit se diçka duhet të ndryshonte. Për të përmirësuar gjendjen ekonomike të Rusisë, ai prezantoi "Reformën e Re Ekonomike"-NEP. Kjo reformë synonte që Lenini të rifitonte mbështetjen e fshatarëve dhe të punëtorëve.

a) Cilat ishin ndryshimet që solli NEP?

3 pikë

Politika e "komunizmit të luftës" solli shumë vështirësi ekonomike që u shoqëruan edhe me rritje të pakënaqësisë në popull që çoi edhe në revolta të dhunshme. Për këtë arsye, bolshevikët kryesisht me iniciativën e Leninit, e panë të udhës të fusnin disa mekanizma ekonomike që do të nxisnin interesin e qytetarëve dhe fshatarësisë për punë dhe rritje të prodhimit. U lejua prona private, kështu që fabrikat kryesisht ato të industrisë së lehtë që kishin të punësuar më pak se 20 punëtorë, nuk ishin më pronë e shtetit. U lejua dhe u nxit tregtia private në qytet dhe fshat. Sistemi i sekuestrimit të prodhimit të konsideruar të tepërt dhe zëvendësimin e tij me një sistem taksimi të fshatarësisë. Kjo rriti interesimin e këtyre të fundit për të prodhuar më shumë dhe tregtuar sasinë mbi nevojat për konsum familjar. U fut në përdorim paraja fizike që ishte eliminuar në periudhën e "komunizmit të luftës". Gjithsesi, shteti kontrollonte industrinë e rëndë, sektorin bankar dhe tregtinë me jashtë.

b) Shpjegoni tri nga sukseset dhe dy nga dështimet e NEP.

5 pikë

Sukseset:

- Prodhimi në 1926 arriti në nivelin e 1913.
- Fshatarët përfituan dhe kishin një shpërndarje më të mirë të produkteve bujqësore.
- Tregtarët që blinin nga fshatarët ia shisnin produktin punëtorëve. Disa tregtarë u rimëkëmbën, madje arritën fitime të mëdha

Dështimet:

- Punëtorët e industrisë nuk përfituan nga kjo politikë.
- Edhe pse pati disa suksese përsëri arritjet e ekonomisë ruse nuk ishin mbresëlënëse po të krahasoheshin me periudhën e sukseseve të mëdha ekonomisë gjermane, amerikane dhe asaj japoneze.

c) Pas vdekjes së Leninit në vitin 1924, pushteti kaloi në duart e Stalinit. Politika ekonomike e Rusisë do të pësonte ndryshime duke u larguar nga NEP. Forca potenciale e saj qëndronte në fuqinë e saj bujqësore. Në qoftë se miliona fshatarë do të menaxhonin më mirë prodhimin e tyre, vendi mund të prodhonte shumë më tepër. Prandaj, plani për bujqësinë u bazua në idenë e kolektivizimit. Sipas Stalinit kolektivizimi kishte disa përfitime. Jepni dy prej tyre.

2 pikë

- U rikthye politika e centralizimit të ekonomisë dhe kontrollit kapilar nga ana e shtetit e mjeteve të prodhimit.
- U lëviz në drejtim të futjes së planifikimit të qëndrueshëm të prodhimit.
- Goditej klasa e kulakëve- fshatarëve të pasur që ishin kundërshtarë të ideologjisë bolshevike duke iu rikthyer sekuestrimeve të prodhimeve bujqësore e në veçanti të grurit.
- Më e rëndësishmja ishte që sasinë e mëdha të drithërave që qeveria i merrte fshatarësisë, do të eksportoheshin për të kompensuar importin e teknologjisë dhe ekspertizës, duke krijuar mundësinë për të shtyrë përpara procesin e industrializimit si dhe për të përballuar ushqimin e popullsisë urbane në rritje.
- Nisi presioni për procesin e kolektivizimit në bujqësi si luftë ndaj pronës private në përgjithësi dhe si përpjekje për përdorimin e makinerive të mëdha në vend të makinerive të vogla që përdornin feramat private.

3. "Enver Hoxha ndërtonte taktikat e thurte rrjetat. Kur e shikonte të udhës, lëshonte pak pe, bënte sondazhe, maste pulset e pastaj i fuste peshqit në rrjetë... Ai vetë ishte autor i të gjithave. Ai nuk mund të lejonte që "pranvera e shkurtër" e Shqipërisë të viteve '70-'71 të kthehej në furtunë për pushtetin".

Agim Mero, ish-sekretar i Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë, gazeta Panorama 19 gusht 2013

- a) Cili kontekst ndërkombëtar i lidhur me Shqipërinë shërbeu si sfond për fushatën e goditjeve brenda strukturave të PPSH në vitet 1973–1975. **2 pikë**

Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të bllokut lindor në vitet 1960-1961 dhe pas daljes edhe zyrtare nga Traktati i Varshavës në 1968, Shqipëria u orientua nga Kina në funksion të marrëdhënieve politike, ekonomike dhe ushtarake. Për disa vite, Kina u kthye në vendin e vetëm që furnizonte me ndihma apo kredi Shqipërinë.

Fillimi i viteve '70 solli një ftohje të marrëdhënieve, deri atëherë të ngushta, mes Kinës dhe Shqipërisë. Përmirësimi i marrëdhënieve të Kinës me SHBA të kulmuara më vizitën e Niksonit në Kinë në shkurt 1972, u përçoll me tronditje në qarqet më të larta të pushtetit në Shqipëri. Ato iu kundërvunë kësaj lëvizjeje diplomatike në terma ideologjike dhe kjo solli një çarje dhe divergim gjithnjë e më të madh mes interesave të Kinës dhe të Shqipërisë. Edhe orientimi i dhënë nga Kina për një bashkëpunim më të madh me Jugosllavinë dhe Rumaninë e shtoi shqetësimin në udhëheqjen shqiptare dhe posaçërisht tek Enver Hoxha lidhur me implikimet e qëndrimeve të reja të Kinës. Këto konjuktura të marrëdhënieve ndërkombëtare nisën të pasqyrohen edhe në gjendjen e brendshme, sidomos ekonomike, duke sjellë edhe një rritje tensioni në skenën politike shqiptare.

- b) Cila ishte ngjarja artistike që u përdor si pretekst për goditjen e "grupit armiqësor" në art dhe kulturë dhe cilët ishin përfaqësuesit kryesorë partiakë që patën pasoja për shkak të kësaj goditjeje? **2 pikë**

Si pretekst për nisjen e goditjeve politike në fushën e artit dhe kulturës në përgjithësi shërbeu Festivali i 11 i Këngës në RTSH në dhjetor 1972.

Personazhet politike kryesore që u goditën në art dhe kulturë ishin Todi Lubonja dhe Fadil Paçrami.

- c) Shpjegoni drejtimet kryesore të sulmit të Enver Hoxhës në fushën e artit dhe kulturës. **4 pikë**

Drejtimet kryesore të sulmeve ishin kundër:

- tendencave liberale dhe moderniste në art e kulturë.
- shfaqjeve të huaja në sjellje, veshje etj.
- ndikimeve të kulturës perëndimore në jetën dhe shoqërinë shqiptare.

- d) Gjykoni mbi ngjarjet e kësaj periudhe në fusha të tjera të jetës së vendit dhe pasojat për të ardhmen. **4 pikë**

Goditjet në art e kulturë ishin preludi i një fushate shumë më të gjerë spastrimi që përfshiu praktikisht gjithë jetën e vendit, ekonominë dhe mbrojtjen. U dënuan figura të rëndësishme të sektorit ekonomik të cilëve iu faturuan vështirësitë që ishin evidentuar në gjendjen e tregut e standardit të jetesës, nën petkun e "sabotimeve" të ekonomisë.

Po kështu, edhe në fushën e mbrojtjes u zhvillua një fushatë e gjerë spastrimi si masë preventive e ndonjë lëvizje (me shume mundësi e imagjinuar) nga ana e ushtrisë, nën justifikimin e tentativave për "sabotim" të vijës së partisë në ushtri dhe përpjekjeve për përmbysje të qeverisjes.

Pasojat e këtyre fushatave spastruese i gjejmë në rritjen e ndjenjës së terrorit e frikës në radhët e popullsisë në përgjithësi dhe kuadrove partiakë e shtetërore në veçanti, shtimit të problemeve ekonomike me kalimin në regjimin e "mbështetjes në forcat e veta", mungesën e investimeve me fonde të huaja (kineze) etj.

4. Ahmet Zogu në situatën e pastabilizuar pas shtypjes së Revolucionit të vitit 1924, duke njohur aspiratat e shqiptarëve për një regjim republikan dhe i bindur se edhe Evropa e përparuar do të mirëpriste gjithashtu një regjim të tillë, vendosi të shpallte Republikën. Republika e shpallur ishte e tipit presidencial. Presidenti ishte kreu i shtetit dhe kryetar i ekzekutivit, pra kryente edhe funksionin e Kryeministrit.

a) Analizoni funksionet që kryente Presidenti i Republikës.

5 pikë

- Presidenti ishte kreu i shtetit dhe kryetar i ekzekutivit, pra kryente edhe funksionin e Kryeministrit
- Presidenti vepronte si kryetar i shtetit dhe i qeverisë.
- Kontrollonte kabinetin, emëronte dhe pushonte çdo ministër.
- Kontrollonte Senatin, në të cilin kishte të drejtë të caktonte gjashtë anëtar, ndërsa pjesa tjetër zgjidhej prej Asamblesë.
- Komandonte forcat e armatosura dhe gëzonte të drejtën e emërimit dhe të pushimit të të gjithë oficerëve të lartë.
- Gëzonte të drejtën supreme të nismës për ndryshimin e Kushtetutës dhe vetëm ai kishte të drejtë të propozonte ligje për rritjen e buxhetit dhe për mënyrën e shpërndarjes.
- Kishte të drejtën e vetos mbi ligjet e ndryshme që vinin për miratim.
- Mund të shpërndante parlamentin dhe të caktonte zgjedhje të reja në çdo kohë.
- Etj.

b) Në 1 shtator 1928, ditën që u miratua Statuti i ri nga Asambleja Kushtetuese, u shpall Monarkia shqiptare dhe Ahmet Zogu mbret i shqiptarëve, me emrin Zogu I.

Analizoni funksionet që statuti i monarkisë i njihte Mbretit Zog.

5 pikë

- Mbreti drejtonte drejtpërdrejtë politikën e brendshme dhe të jashtme.
- Mbreti kishte të drejtën të lidhte traktate miqësie dhe aleance dhe traktate të tjera të karakterit politik dhe ushtarak pa qenë nevoja të miratoheshin nga parlamenti.
- Ishte kryekomandant i forcave të armatosura dhe kishte të drejtën të shpallte luftë.
- Emëronte dhe shkarkonte kryeministrin, ministrat dhe funksionarë të lartë të administratës.
- Kontrollonte veprimtarinë e anëtarëve të qeverisë dhe funksionarëve të lartë shtetëror dhe për shkelje i dërgonte në Gjykatën e Lartë të Shtetit.
- Ndërmerre nisma ligjvënëse dhe nxirrte dekrete normative.
- Zotëronte të drejtën e faljes dhe atë të lehtësimit të dënimeve penale.
- Etj.

5. "Italia e re qëndron për republikën dhe unitetin. Italia duhet të jetë republikë, sepse nuk ka asnjë bazë ekzistuese si monarki .

Giuseppe Mazzini, avokat nga Genova, i internuar nga Piemonte në 1831

"Kushdo që e injoron këtë dashuri të rajoneve individuale të Italisë do të ndërtojë gjithmonë mbi rërë".

Carlo Cattaneo, filozof dhe aktivist politik, Lombardi, 1836

"Të gjithë miqtë e vërtetë të vendit duhet të kuptojnë se ata nuk mund ta ndihmojnë vërtet atdheun e tyre, përveçse tubimi në mbështetje të monarkëve legjitimë që i kanë rrënjët në tokën kombëtare".

Konti Camillo Benso di Cavour, politikan nga Piemonte-Sardeni, artikull reviste, 1846

a) Identifikoni rrymat kryesore që vepronin në gjirin e lëvizjes për bashkimin e Italisë dhe shpjegoni diferencat mes tyre. **4 pikë**

Në gjirin e lëvizjes për formimin e shtetit kombëtar italian vepronin rryma të ndryshme që ndonëse kishin një qëllim të përbashkët strategjik, atë të eliminimit të fragmentarizmit territorial dhe përfundimin e pushtimit të disa territoreve veriore italiane nga ana e Austrisë, sërish divergonin për sa i përket rrugëve nëpërmjet të cilave do të arrihej ky qëllim dhe formën e strukturën që do të kishte shteti i bashkuar italian.

Rrymat kryesore ishin:

- Rryma monarkiste që e shikonte Italinë e bashkuar si një shtet unitar me formë qeverisje monarki kushtetuese nën drejtimin e dinastisë Savoia që udhëhiqte Mbretërinë e Sardenjës. Përfaqësuesi kryesor i kësaj rryme ishte konti Cavour, kryeministër i kësaj mbretërie.
- Rryma revolucionare republikane e shikonte Italinë si një shtet unitar, por me formë qeverisje republikane. Frymëzuesi kryesor i kësaj rryme ishte Giuseppe Mazzini. Në këtë rrymë përfshihet edhe Garibaldi.
- Më tej ishte rryma neoguelfe me përfaqësues Vincenzo Gioberti (klerik). Kjo rrymë e shikonte të ardhmen e Italisë si një shtet konfederativ me shtete përbërëse autonome, por nën drejtimin e Papës së Romës.
- Në fund ishte edhe një nën-rrymë republikane që në vend të shtetit unitar, propagandonte krijimin e një konfederate shtetesh. Ndër përfaqësuesit e saj ishte Carlo Cattaneo.

b) Analizoni rrugët e ndjekura në procesin e bashkimit të Italisë dhe identifikoni përfaqësuesit kryesorë të tyre.

4 pikë

Rrugët e ndjekura në procesin e bashkimit të Italisë janë pak a shumë të lidhura me rrymat vepruese në gjirin e lëvizjes për bashkim.

- Rryma monarkiste e kontit Cavour (të moderuarit) e shihnin procesin e bashkimit si kombinim të diplomacisë dhe përpjekjeve ushtarake nga forca të armatosura të rregullta. Kryesisht këtu referenca ishte Mbretëria e Sardenjës që ishte shteti italian më i madh dhe i fuqishëm për kohën. Ky entitet politik shihej nga kjo rrymë si bërthama rreth së cilit do të mbledheshin patriotët italianë për të çuar përpara bashkimin. Kjo rrugë njihet edhe si "bashkim nga lart", pra nga elita aristokrate nën ombrellën e Mbretërisë së Sardenjës.
- Rryma revolucionare e Mazzinit dhe Garibaldit e shihte procesin e bashkimit si një përpjekje kryengritëse revolucionare që do të përfshinte masën e popullit dhe do të merrte me vete edhe elitat sidomos atë borgjeze, që kishte nisur të krijohet, por që ende ishte e dobët. Kjo rrymë nxiti një sërë kryengritjesh dhe revoltash nëpër shtete të ndryshme italiane dhe kundër pushtuesve austriake. Këtu mund të veçohen edhe ekspeditat e drejtuara nga Garibaldi që dhanë një kontribut shumë të madh, sidomos për shkatërrimin e Mbretërisë së Napolit, që kontrollonte Sicilinë dhe Italinë Jugore, duke i bashkuar këto territore me Italinë e bashkuar. Kjo rrugë njihet edhe si "bashkim nga poshtë" pra nga lëvizja popullore.